

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, gjyqtari Besim Susuri, me procesmbajtësen Firdes Santuri, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Petrit Randobrava, nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 par.1.3, nenit 9 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050, në bazë të nenit 31,73 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datë 23 dhjetor viti 2013 marr këtë:

AKTVENDIM

I pandehuri:

Petrit Randobrava, nga i ati Masar, i lindur më 1962 në Prishtinë, me vendbanim në Prizren, rruga "Behari" nr.5, i martuar, baba i dy fëmijëve, din shkrim lexim, ka të kryer fakultetin e arqitekturës, me profesion arqitekt, i gjendjes së mesme pronësore, shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË PËRGJEGJËSE

Sepse, si zyrtar i lartë- Këshilltarë i Kuvendit Komunal në Prizren, duke mos vepruar sipas kërkesës së Agjencionit Kundër Korrupsion, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2012 deri më afatin e paraparë Ligjor 31.03.2012.

Me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni neni 5,6 par.1.3, nenit 9 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050, për këtë:

DËNOHET

Me gjobë në lartësi prej 300 €. (treqind) Euro.

I pandehuri është i obliguar që gjobën e shqiptuar ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit, në të kundërtën gjoba do të zëvendësohet me dënim burgimi në atë mënyrë që për çdo **20 Euro** te gjobës do të caktohet një ditë burgim. Obligohet se në afatin e njëjtë ti paguaj shpenzimet e procedurës, shumë paushalle prej **5€**. me kërcënim të përmbarimit me detyrim. Obligohet i pandehuri që pas kryerjes së gjobës dhe të shpenzimeve për këtë ta njoftoi Gjykatën Themelore në Prizren - Divizionin e kundërvajtjes.

Arsyetim

Duke vepruar sipas kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të Agjencisë Kundër Korrupsion në Prishtinë, me nr. 01-1882/12 të datës 24.05.2012, është zhvilluar procedurë kundërvajtëse

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA NR. FOLV - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPE / DMP	Nr. Prot 03-99/14
Dep. DPE / DMP	Sr. Prot 03-99/14
Nr. i faq. 03	Prot No 03-99/14
Broj stranica 03	Data 10.01.2014
Nr. pages 03	Datum 10.01.2014
PRISHTINE	

